

Numri: KSC-BC-2020-07

Vendos: Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Hysni Gucati

Data: 29 shtator 2020

Gjuha: anglishte

Titulli i Dosjes: *Prokurori i Specializuar k. Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucati*

KLASIFIKIMI: Publik

PJESËMARRËSIT TË CILËVE DUHET T'IU SHPËRNDAHET PARASHTRIMI:

Gjykatësit të Vetëm, ZPS-së, Kryetares së Dhomave të Specializuara, Mbrojtësit të

Specializuar për z. Haradinaj

---

**Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2):**

**Kërkesë për caktimin e një gjykatësi tjetër për të vendosur në lidhje me  
kundërshtimin**

---

Zyra e Prokurorit të Specializuar  
Valeria Boliçi (Valeria Bolic)

Mbrojtësi i specializuar për z. Gucati  
Xhonatan Elistan Ris QC

Bashkëmbrojtësi i specializuar për z. Gucati  
Valon Hasani

**Kundërshtim i Ligjshmërisë së Arrestimit në Pajtim me Nenin 41(2):**  
**Kërkesë për caktimin e një gjykatësi tjetër për të vendosur në lidhje me**  
**kundërshtimin**

1. Parashtruesi, z. Gucati, e kundërshton ligjshmërinë e arrestimit të tij në pajtim me nenin 41(2) të Ligjit Nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji").
2. Neni 41(2) i Ligjit thotë se:

“Çdo person që privohet nga liria me anë të arrestimit ose paraburgimit ka të drejtë ... paraqesë ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij ... dhe që ajo ankesë të vendoset me shpejtësi nga Dhomat e Specializuara dhe nëse ai paraburgim nuk është i ligjshëm, të urdhërohet lirimi i tij ose i saj.”
3. Në rastin konkret, arrestimi dhe paraburgimi i parashtruesit është autorizuar nga gjykatësi i vetëm, Nikola Giju. Kundërshtimi i paraqitur nga parashtruesi vë në pyetje ligjshmërinë e autoritetit të gjykatësit të ditur për të urdhëruar arrestimin dhe paraburgimin (shih parashtrimin e protokolluar me titull, “Kundërshtimi i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm”).
4. Parashtruesi argumenton se në këto rrethana duhet të caktohet një gjykatës tjetër për të gjykuar atë kundërshtim, i cili të marrë sërish në shqyrtim fushëveprimin e kompetencave ose kompetencat e gjykatësit të vetëm për urdhërimin e arrestimit para ngritjes së aktakuzës:

5. Gjykatësi i ditur është caktuar sipas nenit 33(2) të Ligjit para kërkesës për fletarrestim, ku përcaktohet se caktimi është i përkohshëm dhe përfundon posa të jetë zgjidhur çështja që e ka iniciuar caktimin. Vendimi në lidhje me kërkesën për fletarrestim është marrë dhe rrjedhimisht caktimi i gjykatësit të ditur duhet të përfundojë. Kundërshtimi i ligjshmërisë së arrestimit dhe çështjeve të tjera që burojnë nga ai janë çështje të reja që duhet të shqyrtohen nga një gjykatës tjetër.
6. Synimi i këtij parashtrimi nuk është përçmimi i gjykatësit Giju. Kërkesa për fletarrestim është bërë *ex parte* dhe nuk dihet shkalla e ndihmës që ka pasur gjykatësi i ditur sa i përket kompetencës në nenin 39(3) të Ligjit.

Numri i fjalëve (në origjinal): 468 fjalë

/nënshkrim/

XHONATAN ELISTAN RIS QC

Mbrojtësi i specializuar për parashtruesin

VALON HASANI

Bashkëmbrojtësi i specializuar për parashtruesin:

29 shtator 2020

Cardiff, Britani e Madhe